



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KONCESIONEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __. __. 2023

Lënda: Raport i monitorimit të ATRAKO-s për vitin 2022

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse
Drejtoria e Buxhetit dhe Raportimit Financiar

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) është një institucion buxhetor që ka si mision të nxisë dhe asistojë Autoritetin/et Kontraktor/ë në përgatitjen, vlerësimin dhe negocimin e koncesioneve/partneriteteve publike private.

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve asiston autoritetet kontraktore me qëllim:

- a) Përgatitjen e studimit të fizibilitetit;
- b) Përgatitjen e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe kriterëve të vlerësimit;
- c) Vlerësimin e propozimeve dhe përcaktimin e ofertuesit më të mirë;
- d) Kryerjen e negocimeve dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit

Në përputhje me misionin e saj, me qëllim rritjen e transparencës, respektimin e procedurave për dhënien me koncesion/PPP nga të gjithë Autoritetet Kontraktore dhe standardizimin e tyre Agjencia ka ushtruar funksionet kryesore gjatë vitit 2022:

✓ Asistuar autoritetet kontraktuese, me qëllim:

- a. hartimin e studimit të fizibilitetit për koncesionet/partneritetin publik privat **për 9 (nëntë) projekte;**

- b. përcaktimin e procedurës së zbatueshme për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat dhe hartimin e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe kritereve të vlerësimit për **2 (dy) projekte**;
- c. shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të pranuar dhe/ose kërkesat për pjesëmarrje, që janë dorëzuar për **3 (tre) projekte**;
- d. kryerjen e negocimeve të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat për **5 (pesë) projekte**;
- e. Me qëllim rritjen e transparencës mbi kontratat e koncesionit/PPP, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 211 datë 16.03.2016 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të koncesioneve/PPP” Agjencia ka publikuar sipas informacionit të përcjellë nga Autoritetet Kontraktore, **2 (dy) kontrata dhe 13 (trembedhjetë) Anex kontrate** të publikuar gjatë vitit 2022

Parashikimi i fondeve Publike ne nivel vjetor dhe realizimi për 12-mujorin 2022 me kodin e institucionit 1010277

Mbështetur në ligjin e Buxhetit Nr .115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022“ për periudhën Janar – Dhjetor 2022 janë shpenzuar fondet buxhetore si më poshtë:

a. Shpenzimet Operative për vitin 2022

ART	PLAN VJETOR	SHPENZ THESARI
600	8,800,000	8,641,699
601	1,500,000	1,419,002
600999	10,300,000	10,060,701
602	1,452,000	1,395,166
606	228,000	180,000
602999	1,680,000	1,575,166
230999	0	0
TOTALI	11,980,000	11,635,867

Të ardhurat

Në zbatim të VKM nr. 285 date 10.04.2020 “Per organizimin, funksionimin dhe procedurat e niveli I tarifave te sherbimeve qe do te ofrohen nga ATRAKO”, Agjencia e Trajtitimit të Koncesioneve përfiton të ardhura nga shërbimet e asistencës së kryera pranë Autoriteteve

Kontraktore, për procedurat e dhënies me koncesion/PPP të projekteve nëse këto procedura rezultojnë të suksesshme.

Shuma që do të paguhet për shërbimet e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), shpallet në dokumentet e garës dhe paguhet nga koncesionari fitues, si më poshtë vijon:

Vlera e projektit/leke	Tarifa/LEKE
Për projektet koncesionare deri ne 700,000,000 leke	700, 000 leke
Për projektet koncesionare mbi 700,000,000 leke deri ne 2,100,000,000 leke	1,400,000 leke
Për projektet koncesionare mbi 2,100,000,000 leke deri ne 7,000,000,000 leke	2,800,000 leke
Për projektet koncesionare mbi 7,000,000,000,000 leke	4,200,000 leke

Referuar tarifave sipas tabelës së mësipërme, për 12-mujorin e vitit 2022, për shërbimet e kryera nga Agjencia janë derdhur në Buxhetin e Shtetit nga shoqëri koncesionare të shpallur fitues, gjatë procedurave konkurruese për dhënien me koncesion/PPP per projektin: **Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje të “Portit të Integruar” ne Triport Vlorë** , shuma e arkëtuar në Buxhetin e Shtetit prej **2,800,000 leke.** dhe projekti “Për marrjen me koncesion/PP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitim dhe transferimin e segmentit rrugor Lekaj-Konjat-Fier” shuma e arkëtuar në buxhetin e shtetit për shërbimet e Agjencisë së Trajtimit te Koncesioneve është **4,200,000 leke.**

Propozime për përmirësimin e situatës, me qëllim arritjen dhe përmbushjen e objektivave :

- **Standartizimi i procedurave per monitorimin e kontratave të Koncesionit /PPP-ve**
- **Ristrukturimi i Agjencisë.**

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

KRYETAR

Emiliano Gjika